

1. Informacione te pergjitheshme

ALBRIL Sh.p.k shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në datën 14/01/2016, me numër unik identifikimi (NUIS) L61314003H, në adresën Bulevardi «Dëshmorët e Kombit», Kullat Binjake, Kulla Nr.2, Kati V/2 Tiranë dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, më datë 04 Shkurt 2016 kanë lidhur Kontratën e “Koncensionit/Partneriteti Publik Privat të formës (ROT) për Rehabilitimin, Operimin dhe Transferimin e Infrastrukturës Hekurudhore Fier-Ballsh, Fier-Vlorë”.

2. Deklaratë e pajtueshmërisë me SNRF-të

Pasqyrat financiare(individuele) për qëllime të përgjithshme janë përgatitur dhe paraqiten në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNFR-të) dhe me kerkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

3. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël të zbatuara.

Në përgatitjen e tyre janë përdorur kontabiliteti mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara dhe parimi i vijimësisë,me përjashtim të informacionit lidhur me fluksin monetar. Paraqitja e tyre është bare ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar (Lekë).

Bazat e matjes të përdorura

Bazat e matjes të përdorura në pasqyrat financiare është kosto historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera (kosto aktuale, vlera neto e realizueshme, vlera e drejtë ose shuma e rikuperueshme) sipas kategorive te aktiveve dhe detyrimeve dhe siç e kerkojne standartet perkatese.

Politikat e tjera kontabël të përdorura që janë të rëndësishme për kuptimin e pasqyrave financiare.

a) Aktivitet Afatgjata Materiale

Aktivitet Afatgjata Materiale(AAM-të) bazohen ne modelin e koston dhe zbatohet për të gjithë kategorinë e aktiveve afatgjata materiale.Kosto e një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) që kualifikohet për njohje si aktiv matet me koston e tij. Mbas njohjes fillestare si një aktiv, çdo element i aktiveve afatgjata materiale mbartet me koston e tij minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Vlera kontabël (neto) e AAM-ve rishikohet ne çdo date raportimi dhe kur ekzistojne indikacione që ndonjë aktiv të jetë i zhvlerësuar, atëherë drejtimi çmon shumën e rikuperueshme të aktivitet dhe njuh ate ne perputhje me SNK- 36 Zhvlerësimi i Aktiveve.

Për të shpërndarë shumën e amortizueshme të një aktivi mbi baza sistematike gjatë jetës së tij të dobishme, shoqëria përdor si metodën e zvogelimit te teprices e cila sjell një ngarkesë rënëse përgjatë jetës së dobishme.Metoda e amortizimit aplikohet në mënyrë të qëndrueshme, përveç rasteve kur ka një ndryshim në tiparin e pritshëm të marrjes së përfitimeve ekonomike të ardhshme. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen. Normat e aplikuara per vitet 2018 jane :

Ndertesat	5%
Instalime teknike dhe makineri	20%
Mjete transporti	20%
Paisje zyre	20%
Paisje informatike	25%

b) Investimet ne shoqerite e kontrolluara dhe pjesmarrjet

Investimet në njësitë ekonomike të kontrolluara dhe në pjesëmarrje, në pasqyrat financiare individuale, që nuk janë klasifikuar si të mbajtura për shitje, paraqiten në përputhje me paragrafet 37-42 të SNK 27 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale". Ato njihen fillimisht në kontabilitet me koston e blerjes dhe në pasqyrat financiare pas blerjes, me kosto minus zhvleresimin.

Tepricat që rrjedhin nga marrëdhëniet brenda grupit, dhe të ardhurat e shpenzimet e përealizuara që burojnë nga transaksione brenda grupit, janë eliminuar në momentin që janë përgatitur pasqyrat financiare. Të ardhurat e përealizuara janë eliminuar në përgatitjen e pasqyrave financiare. Shpenzimet e përealizuara janë eliminuar në të njëjten mënyrë si të ardhurat e përealizuara, por vetëm në atë masë kur nuk ka tregues për zhvleresim.

c) Inventarët

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SNK-2 "Inventarët", kur shoqëria i kontrollon apo zotëron ato ekonomikisht apo ligjërisht, kur mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet në lidhje me to, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme.

Njohja si aktiv e inventareve bëhet fillimisht me kosto që përfshin të gjitha kostot e blerjes, kostot e transformimit dhe kosto të tjera të ndodhura për sjelljen e inventarëve në vendndodhjen dhe gjendjen aktuale. Produktet e gatshme vlerësohen në hyrje me kostot standarde që marrin në konsideratë nivelet normale të materialeve, të furniturave, punën, eficientë dhe shfrytëzimin e kapacitetit. Ato shqyrtohen rregullisht dhe, po që se është e nevojshme, ndryshohen duke marrë parasysh kushtet aktuale.

Në bilanc inventarët maten me shumën më të ulët të koston dhe vlerës neto të realizueshme. Çmuarjet e vlerës neto të realizueshme bazohen në evidencën më të besueshme që ekziston, në kohën kur bëhen këto vlerësime dhe marrin në konsideratë luhatjet e çmimit apo të koston që lidhet drejtpërdrejtë me ngjarjet që ndodhin pas mbylljes së bilancit. Shuma e çdo zhvlerësimi të inventarëve deri në vlerën neto të realizueshme dhe të gjitha humbjet e inventarëve njihen si shpenzim në periudhën kur ndodh zhvlerësimi ose humbja.

d) Aktivet financiare

Shoqëria i klasifikon aktivet financiare në Llogari/Kerkesa të arkëtueshme nga klientët dhe në Llogari/Kerkesa të tjera të arkëtueshme. Menaxhimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare. Aktivet financiare paraqiten në bilanc me vlerën neto, pakesuar nga zhvlerësimi nëse ka.

Llogari/Kerkesa të arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njësitë ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë mjete monetare nga klientët e saj. Njohja fillestare e kërkesave për t'u arkëtuar nga klientët ndodh derisa mallrat ose shërbimet e porositura janë nisur për klientin, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer. Kërkesat për tu arkëtuar vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar (kosto fillestare minus arkëtimet e bëra, minus zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka) pavarësisht nga qëllimi i njësisë për t'i mbajtur ato deri në maturim. Një zhvlerësim për rënie vlerë të të drejtave për t'u arkëtuar krijohet atëherë kur ekzistojnë rrethanat që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje që t'i arkëtojë të gjitha shumatat ashtu siç ishte parashikuar në termat fillestare të kërkesave për tu arkëtuar. Konsiderohen tregues të rënies së vlerës së llogarive të arkëtueshme, vështirësi të rëndësishme financiare të debitorit, debitori ka hyrë në rrugën e falimentimit ose riorganizimit financiar, moskryerja apo vonesat në pagesa etj. Shoqëria vlerëson çdo vit mundësinë e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme për secilin klient.

Kërkesa të tjera të arkëtueshme njihen kur njësisia ka një të drejtë për të marrë mjete monetare ose përfitime në të ardhmen si pasojë e një ngjarje të ndodhur, përveç shitjes, dhe kur vlera e përfitimeve matet në mënyrë të besueshme. Kërkesat e tjera të arkëtueshme vlerësohen në hyrje dhe në bilanc me të njëjtën parime si dhe llogaritë e arkëtueshme.

e) Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare përfshijnë mjetet monetare në arkë,banke dhe depozitat me afat. Ekuivalentët e mjeteve monetare janë investime afatshkurtra, shumë likuide dhe të gatshme për t'u konvertuar në shuma të njohura të mjeteve monetare dhe të cilat nuk janë objekt i një rreziku domethënës të ndryshimeve në vlerë.

Flukset monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare.

Veprimtari të shfrytëzimit janë aktivitetet bazë të prodhimit të të ardhurave të njësisë ekonomike dhe aktivitete të tjera të cilat nuk janë aktivitete investuese ose financuese.

Veprimtari investuese janë blerja, dhe nxjerrja e aktiveve afatgjata dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekuivalentët e mjeteve monetare.

Aktivitete financuese janë aktivitetet që cojnë në ndryshime në masën dhe përbërjen e kapitalit neto të kontribuar dhe të dhe huamarrjeve afatgjata ose aftashkurtëra nga njësia ekonomike.

Overdraftet bankare konsiderohen si financim,si flukse nga veprimtaria financiare, dhe si rrjedhim

Paraqitja në bilancin kontabël korespondon me mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

f) Detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata

Detyrimet shoqëria i klasifikon në afatshkurtra dhe afatgjata,bazuar ne percaktimet e SNK-1,"Paraqitja e Pasqyrave Financiare".

Huamarrjet afatshkurtër njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit dhe me pas vlerësohen me koston e amortizuar.Huat klasifikohen si detyrime afatshkurtra, perveç rastit kur shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

Llogaritë të pagueshme ndaj furnitoreve dhe detyrimet e tjera tregtare, njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas në bilanc paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar.

Detyrimet ndaj shtetit për tatimet dhe për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore paraqiten me shumën e tyre të llogaritur sipas kërkesave ligjore në fuqi në datën e ndërtimit të pasqyrave financiare.

Huat afatgjata vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar. Çdo diferencë midis ripagesave (neto nga koston e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas.

g) Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara.

Zakonisht të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura gjatë një periudhe,si dhe efektet e ndryshimeve në çmuarjet kontabël, përfshihen në fitim ose humbje. Megjithatë mund të ekzistojnë rrethana që një zë i veçantë përjashtohet nga fitimi ose humbja e periudhës aktuale, në zbatim të kërkesave të SNK -8 dhe standarteve të tjera.

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose që është për t'u marrë duke marrë parasysh shumat e uljeve dhe zbritjeve tregtare të përfituara.Ato njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve.

Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përllogaritet me besueshmëri.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria zbaton parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtit ushtrim kontabel. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre, pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato.

h) Transaksionet me monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit.. Diferencat nga konvertimi, fitimet ose humbjet, regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2018 janë :

EURO : LEK 123.42

USD : LEK 107.82

k) Tatimi aktual mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit për tu paguar për vitin ushtrimor. Tatimi fitimi i pagueshem për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem për vitin . Fitimi i tatueshem ndryshon nga fitimi neto që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sepse ai përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshme apo të zbritshëm në vite të tjera dhe gjithashtu përjashton zërat që nuk janë kurrë të tatueshem apo të zbritshëm.

Shpenzimet e veprimtarisë kryesore

Informacioni mbi shpenzimet e ushtrimit bazohet në klasifikimin sipas natyrës së tyre. Ato paraqiten të grupuara në zërat; materiale dhe mallra të konsumueshme të përdorura; shpenzimet lidhur me përfitimet e punonjësve; shpenzimet e amortizimit; zhvlerësimi i tokës, ndërtesave, makineri e pajisje dhe në zërin shpenzime të tjera. Disa prej tyre janë shpjeguar në shenimet paraardhese dhe të tjerat jepen në vazhdim. Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e shërbimeve, të pasqyruara në dokumentat justifikues, janë regjistruar me shumën e paguara ose të pagueshme. Kostoja e punësimit, page dhe sigurime shoqërore, është pasqyruar saktësisht si shpenzim me vlerën e realizuar dhe të dokumentuar.

Taksat lokale e taksat e tatimeve të tjera që lidhen me biznesin janë llogaritur dhe pasqyruar në llogaritë e ushtrimit.

Shpenzimet e tjera që në një masë të konsiderueshme përbehen nga Furnitura , nentrajtime dhe shërbime nga të tre paraqitet e analizuar sipas pasqyrës së mëposhteme .

Sipas natyrës së tyre shpenzimet e ushtrimit 2018 janë treguar në pasqyrën përkatëse




4. Mjete Monetare

Gjendjet e mjetet monetare ne banke dhe arke, ne fillim dhe fund te ushtrimit jane si me poshte:

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Monedha	Viti raportues 31.12.2018		Viti paraardhës 31.12.2017	
			Leke	Valute	Leke	Valute
1	Mjete monetare në arkë	Lekë	10,249		33,062	
2	Mjete monetare në arkë EURO	Euro	18,809	€ 152.40	-	€ -
2	Mjete monetare në bankë ISP	Lekë	66,380		36,429	
3	Mjete monetare në bankë ISP	Euro	1,093,485	€ 8,859.87	3,915,669	€ 29,454.34
4	Mjete monetare në bankë RZB	Lekë	342,623		2,190,966	
5	Mjete monetare në bankë RZB	Euro	558,393	€ 4,524.33	11,290,889	€ 84,923.34
	Shuma		2,089,939	€ 13,536.60	17,467,015	114,378

Gjendjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura ne pasqyrat financiare konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave ne fund të ushtrimit. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, jane përkthyer ne leke duke përdorur kursin e këmbimit të shpallur nga B.Shqipërisë me 31/12/2018

5. Të Drejta të Arkëtueshme Afatshkurtëra

Të drejtat e arketueshme, në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël deklarohen si vijon:

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues	Viti paraardhës
		31/12/2018	31/12/2017
1	Nga Aktiviteti i Shfrytezimit(Kliente)	10,352,805	63,000
2	Njesitë Ekonomike Brenda Grupit		
3	Interesa Pjesëmarrëse në Njesi Ekonomike		
4	Të Tjera (Debitore të tjerë)		
	Shteti-Tatim fitimi I mbartur	140,000	140,000
	Shteti-Tatim fitimi ushtrimit		
	Shteti-Tatim mbi vlerën e shtuar	152,381,798	44,613,537
	Te tjera kërkesa te arketueshme(dogana)	6,008	130,847
	Parapagime	4,337,627	21,307,470
5	Kapital i Nënshkruar i Papaguar	-	-
	Shuma	167,218,237	66,254,854

Ne "Nga Aktiviteti i Rehabilitimit " jane pasqyruar faturat e papaguara per sherbimet e rehabilitimit qe shoqeria ka realizuar gjate vitit ushtrimor si dhe tepricat debitore të marrdhenieve me Klientet. Ndërsa në "Të Tjera (Debitore të tjerë)" jane pasqyruar kërkesat debitore ndaj gjendjes kreditore te doganes. Eshte parapaguar garancia Kontraktuale e qirase Leasing me GATX . Drejtimi mendon se të gjitha kërkesat do të arketohen në nje periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie në vlere.

6.1 Nga Aktiviteti i shfrytezimit (Kliente)




Nr	Emri i Klientit	Viti raportues 31/12/2018		Viti paraardhës 31/12/2017	
		Leke	USD	Leke	Euro
1	Bankers Petroleum Albania Ltd.	10,164,305	\$ 94,271		
2	ALB-Star Sh.p.k	120,000		40,000	-
3	Haxhi Lazaj	68,500		23,000	-
	Shuma	10,352,805	\$ 94,271	63,000	-

6. Inventari

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues	Viti paraardhës
		31/12/2018	31/12/2017
1.	Lënde e Parë dhe Materiale të Konsumueshme		
2.	Prodhime në Proces dhe Gjysëmprodukte		
3.	Produkte të Gatshme	-	-
4.	Mallra për investim	-	-
5.	Aktive Biologjike	2,336,400	96,868,833
6.	AAM të Mbajtura për Shitje	-	-
7.	Parapagime për Inventar	-	-
	Shuma	2,336,400	96,868,833

Politikat kontabel për matjen e inventareve është bazuar në SNK-2 "Inventarët". Fillimisht inventaret njihen me kosto e blerjes që përfshin çmimin e blerjes, taksat e importit dhe tatime të tjera, (përveç atyre që njësia ekonomike i rikuperon nga autoritetet tatimore) transportin, trajtimin dhe kosto të tjera që i ngarkohen drejtpërdrejt blerjes së mallrave, materialeve dhe shërbimeve.

7. Aktive Afatgjata Financiare

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues	Viti paraardhës
		31/12/2018	31/12/2017
1	Tituj Pronësie të Njësive Brenda Grupit		
2	Aksionet e Veta	-	-
3	Të Tjera Financiare	-	-
		-	-
		-	-
	Shuma	-	-

uk janë evidentuar Aktive Afatgjata Financiare në fund të ushtrimit.

8. Aktivët Afatgjata Materiale (AAM-te)

Kostoja, amortizimi i akumuluar dhe vlera kontabël në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor për aktivët afatgjata materiale (AAM-të) paraqiten si vijon:

Nr	Gjendjet dhe levizjet	Ndertesa	Impiante dhe makineri	Te tjera instalime dhe pajisje	Parapagime për Aktive Materiale dhe në Proces	Totali
A	Kosto e AAM-ve 01.01.2017	-	3,492,720	355,013	-	3,847,733
	Shtesat	-	3,330,076	468,472	-	3,798,548
	Pakësimet	-	-	-	-	-
	Kosto e AAM-ve 31.12.2017	-	6,822,796	823,485	-	7,646,281
B	Amortizimi AAM-ve 01.01.2017	-	465,696	58,549	-	524,245
	Amortizimi ushtrimit	-	716,407	106,277	-	822,685
	Amortizimi për daljet e AAM-ve	-	-	-	-	-
	Amortizimi AAM-ve 31.12.2017	-	1,182,103	164,827	-	1,346,930
	Kosto e AAM-ve 01.01.2018	-	6,822,796	823,485	-	7,646,281
	Shtesat	70,097,999	111,360,100	3,059,028	-	184,517,126
	Pakësimet	-	-	-	-	-
	Kosto e AAM-ve 31.12.2018	70,097,999	118,182,896	3,882,513	-	192,163,407
	Amortizimi AAM-ve 01.01.2018	-	1,182,103	164,827	-	1,346,930
	Amortizimi ushtrimit	3,896	1,128,132	162,256	-	1,294,284
	Amortizimi për daljet e AAM-ve	-	-	-	-	-
	Amortizimi AAM-ve 31.12.2018	3,896	2,310,235	327,083	-	2,641,214
C	Zhvlerësimi AAM-ve 01.01.2017	-	-	-	-	-
	Shtesat	-	-	-	-	-
	Pakesimet	-	-	-	-	-
	Zhvlerësimi AAM-ve 31.12.2017	-	-	-	-	-
	Zhvlerësimi AAM-ve 01.01.2018	-	-	-	-	-
	Shtesat	-	-	-	-	-
	Pakesimet	-	-	-	-	-
	Zhvlerësimi AAM-ve 31.12.2018	-	-	-	-	-
D	Vlera neto e AAM-ve 01.01.2017	-	5,640,693	658,658	-	6,299,351
E	Vlera neto e AAM-ve 31.12.2018	70,094,103	115,872,661	3,555,430	-	189,522,204

Si politike kontabel per kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston(SNK-16). Ne koston e njohjes fillestare te një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) jane përfshire çmimi blerjes, përfshirë taksat doganore dhe taksat mbi blerjen jo të rimbursueshme, pasi zbriten skontot tregtare dhe zbritjet tregtare ose kostoja e ndertimit te tij, si dhe çdo kosto të ngarkueshme drejtpërdrejtë për të sjellë aktivin në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi.

Per amortizimin e AAM-ve shoqeria ka zgjedhur metoden e zvogelimit te teprices(amortizim mbi bazen e vleres neto) e cila aplikohet ne menyre te qendrueshme dhe eshte e njejtë me ato qe perdoren per qellime fiskale. Normat e amortizimit të perdorura marrin parasysh jetën e dobishme dhe masa e tyre vjetore sipas grupeve eshte shpjeguar ne shenimin nr.3.2.a. Ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvlerësimi.

9. Aktive Afatgjata Jo-Materiale

Nr	Gjendjet dhe levizjet	Koncesione , Patenta,Licenca,M arka Tregtare	Parapagime për Aktive Afatgjata Jo Materiale ne proces	Aktive Afatgjata Jo Materiale	Totali
A	Kosto e AAJM-ve 01.01.2017	-	4,852,530	84,000	4,936,530
	Shtesat	77,482,837	7,040,165	-	84,523,002
	Pakësimet	-	-	-	-
	Kosto e AAJM-ve 31.12.2017	77,482,837	11,892,695	84,000	89,459,532
	Kosto e AAJM-ve 01.01.2018	77,482,837	11,892,695	84,000	89,459,532
	Shtesat	593,637,500	-	-	593,637,500
	Pakësimet	-	-	-	-
	Kosto e AAM-ve 31.12.2018	671,120,337	11,892,695	84,000	683,097,032
B	Amortizimi AAM-ve 01.01.2017	-	-	10,500	10,500
	Amortizimi ushtrimit	-	-	11,025	11,025
	Amortizimi për daljet e AAM-ve	-	-	-	-
	Amortizimi AAM-ve 31.12.2017	-	-	21,525	21,525
	Amortizimi AAM-ve 01.01.2018	-	-	21,525	21,525
	Amortizimi ushtrimit	-	-	9,372	9,372
	Amortizimi për daljet e AAM-ve	-	-	-	-
	Amortizimi AAJM-ve 31.12.2018	-	-	30,897	30,897
C	Zhvlerësimi AAJM-ve 01.01.2017	-	-	-	-
	Shtesat	-	-	-	-
	Pakesimet	-	-	-	-
	Zhvlerësimi AAJM--ve 31.12.2017	-	-	-	-
	Zhvlerësimi AAJM--ve 01.01.2018	-	-	-	-
	Shtesat	-	-	-	-
	Pakesimet	-	-	-	-
	Zhvlerësimi AAJM--ve 31.12.2018	-	-	-	-
D	Vlera neto e AAJM--ve 01.01.2017	77,482,837	11,892,695	53,103	89,428,635
E	Vlera neto e AAJM--ve 31.12.2018	671,120,337	-	53,103	671,173,440

Kostot e huamarrjes – trajtimi alternativ i lejueshëm (SNK 23)

Kostot e huamarrjes, që janë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e një aktivi të kualifikuar, duhet të kapitalizohen si pjesë e kostos së këtij aktivi. Shuma e kostove të huamarrjes të përshtatshme për kapitalizim duhet të përcaktohet në përputhje me këtë standard.

Sipas trajtimit alternativ të lejueshëm, kostot e huamarrjes, që janë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e një aktivi të kualifikuar, përfshihen në koston e këtij aktivi. Këto kosto të huamarrjes kapitalizohen si pjesë e kostos së aktivitetit kur është e mundur që ato do të sjellin për njësinë




ekonomike përfitime ekonomike të ardhshme dhe kur kostot mund të maten në mënyrë të besueshme. Të tjera kosto të huamarrjes njihen si shpenzime në periudhën në të cilën ato kryhen. Në rastin kur fondet merren hua për qëllim të përgjithshëm dhe përdoren për të përftuar një aktiv të kualifikuar, shuma e kostove të huamarrjes të përshtatshme për kapitalizim do të përcaktohet duke zbatuar një normë kapitalizimi mbi shpenzimet e këtij aktivi. Norma e kapitalizimit do të jetë mesatarja e ponderuar e kostove të huamarrjes, e zbatueshme për huamarrjet e njësisë ekonomike që janë të pakthyera gjatë periudhës, duke përfshirë huamarrjet e bëra posaçërisht me qëllim përftimin e aktivit të kualifikuar. Shuma e kostove të huamarrjes e kapitalizuar gjatë një periudhe nuk duhet të tejkalojë shumën e kostove të huamarrjes të kryera gjatë periudhës.

Fillimi i kapitalizimit

Kapitalizimi i kostove të huamarrjes si pjesë e kostos së aktivit të kualifikuar do të fillojë atëherë kur:

- Shpenzimet për aktivin kanë filluar të kryhen;
- Kostot e huamarrjes kanë filluar të kryhen; dhe
- Aktivitetet e nevojshme, që aktivi të përgatitet për qëllim përdorimi të kërkuar, janë në pro

10. Detyrime Afatshkurtëra

Detyrimet afatshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2018 paraqiten:

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 31/12/2018	Viti paraardhës 31/12/2017
1	Titujt e Huamarrjes	-	-
2	Detyrime ndaj Institucioneve të Kredisë	-	-
3	Arkëtime në Avancë për Porosi	-	-
4	Të Pagueshme për Aktivitetin e Shfrytëzimit(furnitore)	663,242,669	90,751,094
5	Dëftesa të Pagueshme	-	-
6	Të Pagueshme ndaj Njës.Ekon. Grup	-	-
7	Të Pagueshme ndaj Njës.Ekon. Pjesëmarrje	208,767	-
8	Të Pagueshme ndaj Punonjësve dhe Sigurime shoq./shëndet	3,874,027	322,120
	Paga dhe shpërblime	2,706,619	-
	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,167,408	322,120
9	Të Pagueshme për Detyrime Tatimore	-	-
	Shteti-Tatim mbi fitimin	-	-
	Shteti-Tatim mbi vlerën e shtuar	-	-
	Tatim mbi të ardhurat personale	-	-
	Tatimi ne burim	-	-
10	Të Tjera të Pagueshme	69,000	69,000
	Shuma	667,394,462	91,142,214

“Të Pagueshme për Aktivitetin e Shfrytëzimit (furnitore) paraqet detyrimet e mbetura pa u paguar ndaj nenkontraktoreve dhe furnitoreve e cila shoqerohet me nje inventar debie.

“Të Pagueshme ndaj Punonjësve dhe Sigurime shoq./shëndet.” paraqet detyrimet e mbetura pa u paguar ndaj personelit dhe detyrimin e muajit Dhjetor 2018

“Te Pagueshme per Tatimin mbi te ardhurat personale paraqet detyrimet e mbetura pa u paguar ne Dhjetor 2018

Te pagueshme per Aktivitetin e Shfrytezimit (Furnitore)

Emri i Furnitorit	Viti raportues 31.12.2018		Viti paraardhës 31.12.2017	
	Leke	Euro	Leke	Euro
ALB-STAR SH.P.K	417,017,226	€ 36,333.34	67,987,843	€ 500.00
Matix Konstruksion Sh.p.k	150,524,449	€ 1,333.33		
16 Februar L.t.D		€ 474,545.00	17,141,244	€ 128,930.00
Vibtis Sh.p.k	3,361,991	€ 13,517.20		
Infra Trans Project Sh.p.k	814,140		694,140	
I.Xh.ISUFI SECURITY Sh.p.k	5,591,264			
APM Sh.p.k	2,249,212	€ 129,116.00		
C.E.C GROUP SH.P.K	1,566,667	€ 3,600.00	1,566,667	
ABKONS SH.P.K	120,000		120,000	
Wagon Services Ostroda Sp		€ 900.00		
Univers Promotion	200,322			
AOS Sh.p.k	86,000			
Finman		€ 580.82		
IT PARTNER SH.P.K	(1,200)		1,200	
ARC sh.p.k		€ 1,347.62		
Saip Bizgjoni	20,628	€ -		
Qafzez Sh.p.k	76,248			
UKF	480			
Shuma	581,627,427	661,273	87,511,094	129,430

Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane te vleresuara realisht.

11. Detyrimet Afatgjata

Detyrimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2018 paraqiten:

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 31.12.2018	Viti paraardhës 31.12.2017
1	Titujt e Huamarrjes	-	-
2	Detyrime ndaj Institucioneve të Kredisë	2,916,927	4,504,927
3	Arkëtime në Avancë për Porosi	-	-
4	Të Pagueshme për Aktivitet Shfrytëzuese(Furnitore)	-	-
5	Dëftesa të Pagueshme	-	-
6	Të Pagueshme ndaj njesive ekonomike te grupit	286,587,199	86,959,123
7	Të Pagueshme Ndaj Njës.Ekon. Pjesëmarrje	-	-
8	Të Tjera të Pagueshme	73,778,008	-
	Shuma	363,282,134	91,464,050

Te pagueshme ndaj njesive ekonomike te grupit.

Nr	Ortakët e shoqërisë ALBRIL	Viti raportues 31/12/2018	Viti raportues 31/12/2017
		Leke	Leke
1	Alb-Star Sh.p.k	136,716,666.0	13,405,790
2	Matriks Konstruksion sh.p.k	16,576,933.0	6,703,333
3	ARC Sh.p.k	30,669,870.0	22,528,450
4	FINMAN Sh.p.k	53,255,730.0	44,321,550
4	Vibtis Sh.p.k	49,368,000.0	
	Shuma	286,587,199	86,959,123

“Te pagueshme ndaj njesis Ekon. Grup” perfaqeson Huamarriet nga Ortaket e Shoqerise Albrail per zbatimin e kontratës konçesionare “Për Rehabilitimi, Operimi dhe Transferimi (Rot) e Rrjetit të Transportit Hekurudhor në Linjat Fier – Ballsh dhe Fier – Vlorë

Shoqëria “FINMAN” Sh.p.k.(në cilësinë e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë “ALB-STAR), ka dhene hua në vleren 100,000 Eur,në funksion të zhvillimit të aktivitetit të investimit të projektit konçensionar te shoqerise ALBRIL.

Shoqëria “VIBTIS ” Sh.p.k, ka dhene hua në vleren 400,000 Eur,në funksion të zhvillimit të aktivitetit të investimit të projektit konçensionar te shoqerise ALBRIL

Zeri “Te tjera te Pagueshme “ ne vleren 73,778,008 Leke perfaqeson kontraten Leasing me kompanine GATX Rail Austria GmbH ,per marjen me qira te 27 vagoneve cistern per nje periudhe kohore 4 vjeçare .Data e fillimit te kontrates eshte 15.11.2018.

“Detyrimi ndaj institucioneve te kredis” ne vitin 2016 , perfaqeson kredine ne forme qira financiare te marre ne Raiffeisen Bank ne vlera 25 200 euro ,per blerje makineri per nevoja te shoqerise per ALBRIL shpk,e shlyer periodikisht sipas faturave tatimore. Detyrimi ne fund te vitit 2018 eshte ne vleren 12,577.75Euro.

“Detyrimi ndaj institucioneve te kredis” ne vitin 2017 ,perfaqeson kredine ne forme qira financiare te marre ne Albanian Financial Institucional Sh.p.k ne vlera 24 950 euro,per blerje makineri per nevoja te shoqerise per ALBRIL shpk,e shlyer periodikisht sipas faturave tatimore. Detyrimi ne fund te vitit 2018 eshte ne vleren 13,881 Euro.

13. Kapitali dhe rezervat.

1.Në përputhje me kontratën Nr.1169 Rep dhe Nr. 240 Kol, datë 03.11.2016 për Shitblerjen e pjesëve të Kuotës së Ortakut “ALB-STAR” në Shoqërinë Konçesionare në favor të blerësve “Matrix Konstruksion” Sh.p.k dhe “ARC” sh.p.k, sipas pjesëve të përcaktuara në kontratën e sipërpërmendur, “ALBRIL“ Sh.p.k ka kërkuar nga Autoriteti Kontraktues (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës) aprovimin e transferimit të pjesëve të kuotës në pronësi të shoqërisë “ALB-STAR” në favor të blerësve të cituar më sipër.

Më datë 14.04.2017 nëpërmjet shkresës Nr.2160/1 Prot, MTI ka rënë dakord dhe ka miratuar zyrtarisht transferimin e pjesëve të kuotës së “ALB-STAR” në Shoqërinë Konçesionare sipas kërkesës së paraqitur nga ALBRIL dhe parashikimeve kontraktuale.

Kuotat e reja pas shitblerjes jane :

- ALB-STAR shpk - 66.3 % pjesëmarrje
- Matrix Konstruksion shpk – 16.85 % pjesëmarrje
- Arc Sh.p.k – 16.85 % pjesëmarrje

2.Për nevoja të administrimit dhe financimit të aktivitetit konçensionar të shoqërisë, bazuar në Nenin 8 të Statutit të Shoqërisë dhe ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008 «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare » i ndryshuar ,kapitali i rregjistruar i shoqerise eshte zmadhuar .Ortakët kane rene dakord per Miratimin e financimeve me kontribute të reja në vlera monetare të secilit prej ortakëve sipas pjesës korresponduese me përqindjen e pjesëmarrjes që zotëron secili në kapitalin themeltar zmadhimim e vlerës së përgjithshme të kapitalit themeltar të shoqërisë nga vlera prej 1.000.000 Lekë (një milion) në vlerën prej 135.300.000 (njëqind e tridhjetë e pesë milion e treqind mijë Lekë) vendimi eshte depozituara ne QKB .

Me 31.12.2018 ai eshte 135.300.000 leke,



Raportet e zoterimit te kapitalit te regjistruar per vitin ushtrimor 2018 paraqiten:

Emerimi	Kuotat e Kapitalit ne %	Kuotat e Kapitalit ne LEK	
ALB-STAR SH.P.K	66.30%	ALL	89,703,900.00
Matix Konstruksion Sh.p.k	16.85%	ALL	22,798,050.00
ARC sh.p.k	16.85%	ALL	22,798,050.00
Shuma	100%		135,300,000

12. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit dhe të tjera

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 31.12.2018	Viti paraardhës 31.12.2017
1	Të Ardhura nga Aktiviteti i Shfrytëzimit:		
	Shitje e produkteve te gatëshme dhe nënprodukteve	8,493,398	-
	Shitja e punimeve dhe shërbimeve		
	Shitja e mallrave		
	Të ardhura nga shitje të tjera(qera,komisione,etj)	996,000	232,000
	Totali i të Ardhura nga Aktiviteti i Shfrytëzimit	9,489,398	232,000
2	Puna e Kryer nga Nj.E dhe e kapitalizuar		-
3	Të Ardhura të Tjera të Shfrytëzimit		
	Të ardhura nga Shitja e Aktiveve Afategjata		
	Të ardhura të tjera(grantet,te tjera,.....)	-	-
4	Ndryshimi në Inventarin e Produkteve të gatshme dhe prodhim	-	-
	Shuma	9,489,398	232,000

16.Shpenzimet e për lëndë të parë dhe materiale për investim

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 31.12.2018	Viti paraardhës 31.12.2017
1	Lënda e Parë dhe Materiale të Konsumueshme		
	Lënda e Parë dhe Materiale	-	-
	Mallra (per investim)	2,336,400	96,868,833
2	Të Tjera Shpenzime	-	-
	SHUMA	2,336,400	96,868,833

17 Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit përbehen nga pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, leja vjetore e paguar,raporti mjekësor i paguar në 14 ditët e para, pjesëmarrja në fitime dhe shpërblimet.

Numri mesatar i punonjesve dhe shpenzimet vjetore të kryera për personelin janë si me poshtë :



Kategorite	Numer mesatar	Ushtrimi 2018(leke)			Ushtrimi 2017(leke)	
		Paga	Sigurime punedhenesi	mesata r	Paga	Sigurime punedhenesi
Shpenzime Personeli	27	16,093,981	2,445,544	22	9,607,913	1,398,253
Shuma	27	16,093,981	2,445,544	22	9,607,913	1,398,253

Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar. Nr mesatar i punonjesve ne Shqiperi eshte 27 .

18.Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Në shpenzime të tjera të shfrytëzimit janë përfshire kostot e shërbimeve kryesore dhe ndihmëse, që lidhen drejtpërdrejt me veprimtaritë e shfrytëzimit dhe ato për qëllime administrative,si dhe, kostot që ndodhin jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të biznesit.

Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 31.12.2018	Viti paraardhës 31.12.2017
4-Materialet e konsumuara	382,678	55,465
a-Lende te para (601-608)		
b-Produkte kancelairie	55,869	55,465
c-Mallra (601-608)		0
d-te tjera	326,809	0
7-Shpenzime te tjera (61-63)	25,462,902	12,139,405
Trajtime të përgjithshme(nga te trete)	11,234,097	8,875,626
Qera	4,441,541	804,805
Mirmbajtje dhe riparime	478,955	35,176
Sigurime	713,872	600,000
Publicitet, reklama	-	14,600
Shpenzime Juridike/Noterial	141,901	60,317
Trasferime,udhëtime,dieta	-	298,386
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	116,205	
Shpenzime transporti	5,669,292	
Shpenzime për shërbimet bankare	237,459	
Shpenzime për uje e drita	405,432	32,893
Shpenzime Karburanti	446,800	
Te tjera	1,577,348	1,417,602
Tatime dhe taksa(llog.63)	508,030	5,415,876
Taksa dhe tarifa vendore	508,030	184,930
Taksa te regjistrimit		-
Tatime te tjera doganore	-	5,230,946
Shpenzime të tjera jo korente(llog.67)	-	-
Vlera kontabël e AA te shitura		
Shpenzime të Tjera Shfrytëzimi(Gjoba,provizione) Llog.65,68)	0	0
Shpenzime per pritje dhe përfaqësime		
Gjoba dëmshpërblime		
Provizione		
Te tjera		
Shuma	26,353,610.27	17,610,745.58

Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit.

Shpenzimet e tjera qe ne nje mase te konsiderueshme perbehen nga Furnitura, nentrajtme dhe sherbime nga te trete paraqitet e analizuar sipas pasqyres se mesiperme.

Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2018 jane treguar ne pasqyren perkatese.

13. Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 31.12.2018	Viti paraardhës 31.12.2017
1	Të ardhurat nga interesat 767, 667(+)		
2	Shpenzimet per interesat 767, 668(-)	(254,003.0)	(231,258.0)
3	Shpenzime për shërbimet bankare	(237,459.0)	(239,712.0)
4	Fitimet nga kursi i këmbimi 769, 669(+)	17,330,090.0	(517,578.1)
5	Humbjet nga kursi i këmbimi 769, 670(-)		
6	Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668	(1,853,338.5)	-
	Shuma	14,985,290	(988,548)

Jane paraqitur si difference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve. Shpenzim per interes perfaqeson Interesat e Leasing ..

14. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Nr.	Emertimi	Viti raportues 31.12.2018	Viti paraardhës 31.12.2017
I	Shpenzimi Aktual i Tatimit mbi Fitimin		
1	Fitimi/(Humbja) Para Tatimit		
2	Të ardhura të njohura që përjashtohen nga tatimi mbi fitimin(-) Dividentët e deklaruar dhe ndarjet e fitimit(nga investimet e kontrollit Të tjera(rimarrje provizionesh,gjobash etj))(-)	-	-
3	Shpenzime te panjohura tatimore(+) Shpezime pritje e dhurime tej kufirit tatimor(+) Gjoha,penalitete,demshperblime(+) Amortizim mbi normat fiskale(+) Provizione per rreziqe e shpenzime(+) Të tjera	-	-
	Diferenca pozitive- Shpenzimet tatimore të lejuara minus njohjet		
4	për qëllimet e raportimit(-) Amortizimi i përshpejtuar tatimor(-) Të tjera(-)	-	-
5	Zbritja e humbjes tatimore(-)	-	-
6	Fitimi i Tatueshëm-Humbja Fiskale(1+2+3+4+5)	(21,930,874)	(30,207,219)
	Shpenzimi Aktual i Tatimit mbi Fitimin(2017-15%)	-	-
II	Shpenzim(të ardhura) i Tatim Fitimit të Shtyrë(+/-)	-	-
III	Shpenzime(të ardhura) për Tatimin mbi Fitimin(I+II)	-	-
	Fitimi/(Humbja) e Vitit Financiar	(21,930,874)	(30,207,219)

Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatushem, i cili eshte rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal, analizuar ne tabelen e mesiperme. Në llogaritjen e shpenzimit aktual të tatimit mbi fitimin jane respektuar kerkesat e legjislacionit fiskal. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 eshte 15%

Informacione shpjeguese për palët e lidhura

Duke marre ne konsiderate te gjitha marredheniet e mundeshme me palet e lidhura, transaksionet e kryera me to, janë bërë sipas termave të njëjta me ato që mbizotërojnë në transaksionet e kryera në mënyrë të vullnetshme midis palëve të palidhura.

Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vijimesia

Asnje ngjarje e rëndësishme nuk eshte evidentuar ndërmjet datës së bilancit dhe datës kur janë miratuar nga drejtimi keto pasqyrat financiare, si per ngjarjet që mund te ekzistonin në datën e bilancit dhe per ato që japin të dhëna pas datës së bilancit.

Pasqyrat financiare te vitit 2018 jane hartuar sipas parimit te vijimesise dhe nga informacionet e besueshme qe zoteron drejtimi nuk ka rreziqe të rëndësishme për të shkaktuar ç'rregullime materiale në vlerën kontabël të aktiveve dhe pasiveve brenda vitit të ardhshëm financiar.

Pasivet e kushtëzuara dhe anagazhimet kontraktuale të panjohura

Drejtimi ka vleresuar se nuk ekzistojne ngjarje të shkuara apo angazhime kontraktuale të panjohura që mund te çojne ne te ardhmen, ne një detyrim i mundshëm ose të një pasivi te kushtëzuar dhe qe nuk jane ne kontrollin e shoqerise.

